

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: SPITALI SHEIKH ZAYED

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	220/70050-26-5432-1-2-1
Nr i brendshëm	70050-26-017-1-2-1

Sa i përket tenderit për: **“Furnizimi dhe montimi i makinave industriale të lavanderisë”**.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“MSI” SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR. Shaqir Igrishta OB Fitorja nr.10

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

044160526

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Nasir Mustafa

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

msishpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

28.07.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

Prishtinë

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e njoftimit për kontratë: 08.07.2026

Data e planifikuar e hapjes së ofertave: 28.07.2026 në ora 12:00

Kërkesë për rishqyrtim: 22.07.2026

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 23.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Bashkangjitur gjeni vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 27 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 17 i RRPP Nr.001/2022

Neni 25 i RRPP Nr.001/2022.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjorbë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Data e njoftimit për kontratë: 08.07.2026, kurse data e planifikuar e hapjes së ofertave ka qenë e parashikuar të bëhet me 28.07.2026 në ora 12:00.

Ne pasi kemi analizuar dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë kemi ardhur në përfundim se kërkesat e dosjes së tenderit janë diskriminuese dhe realisht kufizojnë konkurrencën, ndërsa shpijnë në favorizim të ndonjë kompanie.

Fillimisht po e sqarojmë se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit kemi vërejtur se një OE kishte paraqitur kërkesë për sqarime, duke ngritur shqetësimin se specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që favorizojnë një prodhues të caktuar. Autoriteti kontraktues ka kthyer përgjigje duke deklaruar se specifikimet janë përgatitur mbi bazën e nevojave funksionale dhe nuk favorizojnë asnjë markë.

Mirëpo pas analizës së detajuar që ne kemi bërë, shihet qartë se pothuajse të gjithë parametrat teknik të kërkuar përputhen me karakteristikat teknike të pajisjeve të **prodhuesit/markës IMESA**. Për ta vërtetuar këtë fakt, ne kësaj kërkesë për rishqyrtim do të ja bashkangjesim një analizë krahasuese ndërmjet specifikimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktues dhe specifikimeve teknike të prodhuesit IMESA, nga e cila vërehet se kërkesat janë përshtatur pothuajse plotësisht me karakteristikat e këtij prodhuesi.

Një përputhje e tillë nuk mund të konsiderohet rastësi, pasi numri i parametrave identikë ose pothuajse identikë është i konsiderueshëm dhe tejkalon atë që do të ishte e nevojshme për të përshkruar vetëm funksionalitetin e pajisjes. **(Bashkangjitur gjeni krahasimet e specifikave të AK-së dhe prodhuesit IMESA).**

Për ta sqaruar edhe më shumë faktin se specifikimet teknike kufizojnë pjesëmarrjen e prodhuesve të tjerë të njohur ndërkombëtarisht dhe me qëllim të verifikimit objektiv të specifikimeve teknike, ne si kompani me përvojë të madhe në këtë fushë kemi kontaktuar dhe

kemi kërkuar oferta dhe katalogë teknikë nga disa prej prodhuesve më të njohur të pajisjeve industriale të lavanderisë, konkretisht prodhuesit/markat **DOMUS, PRIMUS, ELECTROLUX PROFESSIONAL dhe FAGOR.**

Pas analizimit të dokumentacionit teknik të këtyre prodhuesve, kemi vërejtur se asnjëri prej tyre nuk i plotëson në tërësi të gjitha specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktues. Edhe pse këta prodhues ofrojnë pajisje me cilësi të lartë dhe performancë të njëjtë ose më të avancuar, ato nuk përputhen me kombinimin specifik të parametrave të kërkuar në dosjen e tenderit.

Prandaj kur kemi parasysh këtë fakt kuptohet qartë se specifikimet teknike për këtë aktivitet të prokurimit nuk janë hartuar mbi bazën e performancës minimale të nevojshme, por janë përcaktuar në atë mënyrë që kufizojnë pjesëmarrjen e prodhuesve të tjerë të njohur në treg, prandaj kërkojmë që të ndryshohen në tërësi specifikimet teknike të pajisjeve, duke u hartuar në mënyrën më të drejtë të mundshme sipas karakteristikave mesatare të tregut dhe jo ti përshtaten saktë një prodhuesi të caktuar.

Për më tepër, **bashkëngjitur kësaj kërkesë për rishqyrtim po paraqesim edhe analizën krahasuese ndërmjet specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktues dhe specifikimeve teknike të prodhuesve të njohur ndërkombëtarë, përkatësisht DOMUS, PRIMUS, ELECTROLUX PROFESSIONAL dhe FAGOR.** Nga kjo analizë vërehet qartë se asnjëri prej këtyre prodhuesve nuk arrin t'i plotësojë në tërësi specifikimet e kërkuara në DT, pavarësisht se bëhet fjalë për kompani me përvojë shumëvjeçare, reputacion ndërkombëtar dhe prezencë të gjerë në tregun e pajisjeve industriale të lavanderisë. Kjo analizë dëshmon se specifikimet teknike nuk janë hartuar mbi baza funksionale apo të performancës minimale, por janë përcaktuar në një mënyrë që praktikisht kufizon mundësinë e ofertimit nga prodhuesit kryesorë të këtij sektori.

Autoriteti kontraktues tek kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar *“Kërkesa 5. Të gjitha pajisjet e ofruara (makinat larëse industriale, tharëset industrial dhe mangël industrial) duhet të jenë të prodhuara nga i njëjti prodhues (brand), me qëllim të sigurimit të kompatibilitetit teknik, integritetit të sistemit, standardizimit të mirëmbajtjes, servisimit dhe furnizimit me pjesë rezervë”,* ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *“Dëshmia 5. Deklaratë nga prodhuesi ose katalogë origjinalë teknikë të prodhuesit që dëshmojnë se të gjitha pajisjet e ofruara janë të njëjtit prodhues”.*

Në lidhje me kërkesën e lartcekur AK-ja në përgjigjen e dhënë ndaj OE që kishte kërkuar sqarime, ishte arsyetuar se kërkesa që makinat larëse, tharëset dhe mangëli të jenë nga i njëjti prodhues është vendosur për arsye të kompatibilitetit teknik, mirëmbajtjes dhe standardizimit.

Përgjigjja e AK-së është jo profesionale sepse pajisjet që janë objekt i këtij aktiviteti të prokurimit funksionojnë si njësi të pavarura dhe nuk janë të varura nga njëra-tjetra në aspektin teknik, pra funksionimi i një makine larëse nuk kushtëzohet nga prodhuesi i tharëses apo i mangëlit, ndërsa secila pajisje kryen funksionin e saj në mënyrë të pavarur.

Për këtë arsye kërkesa që të gjitha pajisjet të jenë domosdoshmërisht nga i njëjti prodhues kufizon pa arsye pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që mund të ofrojnë kombinime të pajisjeve nga prodhues të ndryshëm, të cilat plotësojnë nevojat funksionale të autoritetit kontraktues, prandaj kërkojmë që e njëjta kërkesë të largohet në tërësi nga dosja e tenderit, sepse në këtë mënyrë po ju pamundësohet ofertimi kompanive me përvojë të madhe në fushën e këtij aktiviteti të prokurimit.

Gjithashtu gjatë procedurës së prokurimit kemi vërejtur se një OE kishte kërkuar sqarime edhe lidhur me mënyrën e operimit të makinave larëse industriale, pasi në DT ishin specifikuar tri mënyra të ndryshme të operimit, përkatësisht: Elektrike, Avull dhe Elektrike + Avull. Në përgjigjen e dhënë, autoriteti kontraktues ka sqaruar se operatorët ekonomik mund të ofertojnë

cilëndo nga këto konfigurime, me kusht që konfigurimi i ofertuar të deklarohet në ofertën teknike dhe të jetë në përputhje me kërkesat funksionale të autoritetit kontraktues.

Ky sqarim nuk e eliminon paqartësinë e krijuar nga dosja e tenderit, sepse duke lejuar ofertimin e tre konfigurimeve të ndryshme, autoriteti kontraktues nuk ka sqaruar se cili konfigurim i përgjigjet nevojës reale të tij dhe nëse të tre konfigurimet do të konsiderohen plotësisht të barasvlershme gjatë vlerësimit të ofertave. Për më tepër, konfigurimet me ngrohje elektrike, me avull dhe me ngrohje të kombinuar janë zgjidhje të ndryshme teknike, me karakteristika funksionale dhe kosto të ndryshme.

Prandaj kërkojmë që të riformulohet kjo kërkesë teknike duke përcaktuar qartë konfigurimin që kërkohet ose nëse nevoja e tij mund të përmbushet nga secili prej këtyre konfigurimeve, pra të specifikohet shprehimisht se të gjitha alternativat konsiderohen të barasvlershme dhe do të vlerësohen mbi të njëjtën bazë teknike.

Duke marrë parasysh argumentet dhe dokumentacionin krahasues që i bashkëngjitet kësaj kërkesë për rishqyrtim, është evidente se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktues kufizojnë konkurrencën dhe përputhen pothuajse plotësisht me karakteristikat teknike të një prodhuesi të vetëm (**IMESA**), ndërsa prodhues të tjerë me reputacion ndërkombëtar nuk arrijnë t'i plotësojnë ato në tërësi. Për këtë arsye, kërkojmë që të rishikohen dhe të ndryshohen specifikimet teknike, duke eliminuar kërkesat kufizuese dhe duke mundësuar konkurrencë reale ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Pasi që autoriteti kontraktues edhe në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, e ka shënuar se specifikat teknike nuk i janë përshtat asnjë prodhuesi apo marke të caktuar ne më poshtë po i shënojmë me detaje specifikimet teknike të cilat i janë përshtatur një prodhuesi të caktuar:

Pozicioni 1 në dosjen e tenderit ("Makinë larëse industriale High Spin") paraqet një rast të përshtatjes së specifikimeve teknike me një produkt të vetëm, në mënyrë që asnjë prodhues tjetër në treg të mos mund të marrë pjesë.

Më poshtë është zërthimi i detajuar tekniko-ligjor që provon se specifikimet e Pozicionit 1 janë kopjuar 1:1 nga modeli IMESA LM 26 dhe pse kjo përbën bllokim absolut të konkurrencës:

1. Zërthimi i Specifikimeve Pozicioni 1 : Tenderi vs. IMESA LM 26

Nga dokumenti i tenderit, parametrat e Pozicionit 1 janë vendosur me precizion ekzakt sipas fletës teknike të IMESA LM 26:

- **Kapaciteti dhe Raporti:** Kërkohet min. 26 kg me raport 1:10. Modeli **IMESA LM 26** ka kapacitet ekzakt prej 26 kg (raporti 1: 10).
- **Volumi i Tupanit:** Kërkohet së paku 251 Litra. Vlera prej 251 L është në mënyrë matematike volumi ekzakt i tupanit të modelit IMESA LM 26. Prodhuesit e tjerë përdorin volumet e tyre standarde (p.sh. 240 L ose 280 L).
- **Fuqia e Ngrohjes dhe Instalimit:** Kërkohet Fuqia e ngrohjes: 24 kW dhe Fuqia e instalimit: 28 kW. Këto janë saktësisht vlerat e konsumit dhe fuqisë elektrike të motorit/rezistencave të IMESA LM 26.
- **Dozimi Automatik:** Kërkohet Deri 11 pompa. Standardi i tregut botëror për makinat e këtij kapaciteti është 6 deri në 8 pompa dozuese kimike. Vetëm mikrokontrollori elektronik i serisë LM nga IMESA është i projektuar me kartë zgjerimi deri në 11 pompa dozuese.
- **Dimensionet Maksimale:** Kërkohet 1100 × 1000 × 1500 mm. Dimensionet reale të kornizës së IMESA LM 26 janë 1096 × 990 × 1450 mm, që hyjnë fiks nën këtë

"tavan" kufizues.

- **Parametra të Tjerë Unikë:**

- Shkarkimi: Ø 50 mm me debitim 160 l/min.
- Paneli i kontrollit: Panel elektronik me ekran digjital me prekje plotësisht i programueshëm së paku 7" (që i përgjigjet panelit IM11 Touch Screen të IMESA-s).
- Komunikimi: Wi-Fi, USB, LAN dhe Cloud.

Lidhur me Pozicionin 2 (Makinë larëse industriale High Spin min. 32 kg), situata është identike me Pozicionin 1: specifikimet janë marrë 1:1 nga fleta teknike e modelit IMESA LM 32, duke krijuar një barrierë absolute për çdo brand tjetër në treg.

Zbërthimi i Specifikimeve Teknike Pozicioni 2 : Tenderi vs. IMESA LM 32

Nga dosja e tenderit, parametrat e kërkuar për Pozicionin 2 përkojnë me precizion ekzakt me modelin **IMESA LM 32**:

- **Kapaciteti dhe Raporti:** Kërkohet min. 32 kg me raport 1:10. Modeli **IMESA LM 32** ka kapacitet prej 32 kg me raport 1: 10.
- **Volumi i Tupanit:** Kërkohet së paku 320 Litra. Vlera prej 320 L është në mënyrë matematikore volumi ekzakt i tupanit të IMESA LM 32.
- **Konsumi Elektrik:** Kërkohet 3.2 kWh. Kjo vlerë me një dhjetore është saktësisht konsumi i specifikuar në fletën teknike të IMESA-s.
- **Fuqia e Ngrohjes dhe Instalimit:** Fuqia e ngrohjes: 24 kW dhe Fuqia e instalimit: 29 kW. Këto janë saktësisht specifikimet elektrike të motorit dhe elementeve ngrohëse të modelit LM 32.
- **Dimensionet Maksimale Kufizuese:** Kërkohet 1100 × 1100 × 1500 mm. Dimensionet e IMESA LM 32 janë 1096 × 1090 × 1450 mm, duke u futur fiks brenda këtij kufiri strikt.
- **Sistemi i Centrifugës & Dozimi:** Kërkohet transmetim Poly-V + reduktim mosbalance dhe Dozimi automatik deri 11 pompa. Siç u përmend, karta e zgjerimit me 11 pompa është e veçantë për kontrollorin elektronik të IMESA-s.
- **Teknologjia e Kontrollit:** Panel elektronik me ekran digjital me prekje së paku 7" me komunikim Wi-Fi, USB, LAN dhe Cloud.

Lidhur me Pozicionin 3 (Tharëse industriale / Tumble Dryer 32 kg), shkelja ligjore është edhe më e rëndë dhe më e lehtë për t'u provuar, pasi Autoriteti Kontraktues jo vetëm që ka kopjuar parametrat teknikë, por ka përfshirë emrin direkt të markës/patentes së prodhuesit IMESA në dosjen e tenderit.

Zbërthimi i Specifikimeve Pozicioni 3 Tenderi vs. IMESA ES 32

Nga dokumenti i tenderit, parametrat e Pozicionit 3 përkojnë pikë për pikë me modelin **IMESA ES 32**:

- **Shkelja Direkte e Brand-it:**

- **Kërkesa në Tender:** Paneli i kontrollit: IM10 Touch Screen.
- **E vërteta teknike: "IM10"** është emri tregtar i mbrojtur i panelit me prekje të vetë prodhuesit **IMESA (IM = IMESA)**. Vendosja e këtij emri në tender është shkelje flagrante e Ligjit për Prokurimin Publik, sepse asnjë prodhues tjetër në botë nuk lejohet të përdorë apo të shesë një panel të quajtur "IM10".

- **Kopjimi i Termat e Patentuara të IMESA-s:**

- Sistemi i tharjes: D-FLOW axial airflow (Emërtimi specifik i sistemit të ajrit të patencës së IMESA-s).

- Tupani: INOX AISI 304 Soft Care (Terminologji e veçantë e katalogut të serisë ES).
- Ngrohja: Dual Power (Karakteristikë e sistemit të ngrohjes elektrike të IMESA-s).
- Filtri: Drawer Filter (Dizajni i filtrit në formë sirtari të poshtëm, specifik për serinë ES).
- **Matricat Teknike Unike:**
 - Volumi i tupanit: 572 Litra (Volumi matematik ekzakt i tupanit të IMESA ES 32).
 - Diametri & thellësia e tupanit: 977 mm dhe 775 mm (Saktësisht dimensionet e IMESA ES 32).
 - Diametri i derës: 777 mm (Përmasë e veçantë e derës së serisë ES).
 - Rrjedha e ajrit: 1680 m³/h.
 - Fuqia elektrike e ngrohjes: 30 kW / Fuqia totale: 31.1 kW.
 - Dimensionet maksimale kufizuese: 1010 × 1200 × 2000 mm (Korniza e IMESA ES 32 është 1022 × 1182 × 1948 mm).

Lidhur me Pozicionin 4 (Mangël industrial / Roller Ironer min. 2000 mm), shkelja teknike dhe ligjore është shumë e qartë dhe e pakontestueshme.

Në këtë pozicion, autoriteti kontraktues ka kopjuar nga katalogu i IMESA FI 200/33 jo vetëm emërtime të patentuara, por edhe matje fizike ekzakte me presje dhjetore (si pesha deri në gram), që përbëjnë prova absolute të kopjimit 1: 1 dhe bllokimit të tregut.

Zbërthimi i Specifikimeve Pozicioni 4 : Tenderi vs. IMESA FI 200/33

Parametrat e kërkuar në dosjen e tenderit për Pozicionin 4 dhe përputhja e tyre me modelin IMESA FI 200/33:

- **Proving Fact #1 – Pesha Neto Ekzakte:**
 - **Kërkesa në Tender:** Pesha neto: 213.8 kg.
 - **E vërteta teknike:** Vlera 213.8 kg është pesha ekzakte e strukturës metalike të manguut IMESA FI 200/33. Asnjë prodhues tjetër në botë nuk prodhon një mangël 2-metrash me peshë neto saktësisht 213.8 kg. Kjo shifër me presje dhjetore është prova më e fortë e kopjimit amator të fletës teknike.
- **Proving Fact #2 – Dimensionet Ekzakte:**
 - **Kërkesa në Tender:** Dimensionet (Gj×Th×L): 2550 × 643 × 985 mm.
 - **E vërteta teknike:** Këto janë përmasat e kornizës jashtme fizike të IMESA FI 200/33. Prodhuesit e tjerë kanë dimensione të ndryshme të trupit (p.sh. gjerësi 2400 mm ose 2600 mm, thellësi 700 mm).
- **Proving Fact #3 – Emërtimi i Patencës së Sigurisë:**
 - **Kërkesa në Tender:** Siguria shitesë: Chest Safety Release.
 - **E vërteta teknike:** "Chest Safety Release" është emërtimi specifik i patentuar i IMESA-s për sistemin e sigurisë që liron govatën (chest) në rast se ndalet rryma ose ka bllokim. Prodhuesit e tjerë përdorin sisteme si "Finger Guard", "Emergency Release Lever" ose "Hand Protection Bar".
- **Matricat e tjera të Kopjuara:**
 - Presioni i hekurosjes: 214–322 kg/m² (fashë ekzakte e presionit të IMESA FI 200/33).
 - Kapaciteti i avullimit: minimum 12 l/orë.
 - Niveli i zhurmës: maksimum 46 dB(A).

- Konsumi energjetik: maksimum 11.2 kWh/orë dhe rryma nominale 20 A @400V.

1. Makina Larëse 26 kg (Pozicioni 1)

Tenderi kërkon që makina të ketë volum **ekzaktësisht të paktën 251 litra**, fuqi ngrohje **24 kW**, dhe të mbështesë deri në **11 pompa kimike**.

- **Pse nuk mund të ofertojnë OE të tjerë, përveç OE i cili e deklaron prodhues kompaninë IMESA?**
 - **Electrolux** bën makina 27 kg, por volumi i saj është 240 litra (mungojnë 11 litra) dhe ka fuqi 18 kW. Skualifikohet!
 - **Primus** bën makina 28 kg me volum 280 litra, por gjerësia e trupit të saj është pak më e madhe se 110 cm. Skualifikohet!
 - **Përfundimi:** Asnjë brand tjetër nuk ka fiks kombinimin: 251 litra + 24 kW + 11 pompa + nën 110 cm gjerësi. Këtë e ka **VETËM IMESA LM 26**.

2. Makina Larëse 32 kg (Pozicioni 2)

- Kërkohej volum **320 litra**, konsum ekzakt prej **3.2 kWh**, fuqi **29 kW** dhe përsëri **11 pompa dozuese**.
- **Pse dështojnë të tjerët?**
 - Brand-et e tjera si Electrolux apo Girbau përdorin sisteme elektronike standarde që lidhin deri në 8 pompa kimike (sepse 8 pompa mjaftojnë për çdo lloj larjeje). Vetëm komputeri i IMESA-s është i ndërtuar me kartë për 11 pompa.
 - Po ashtu, konsumi prej 3.2 kWh dhe ngrohja 29 kW janë matje specifike vetëm të motorit të IMESA LM 32.

3. Tharësja 32 kg (Pozicioni 3)

- Në këtë pozicion, personi që ka shkruar tenderin ka bërë një gabim shumë të madh: ka shkruar me shkronja të para emrin e kompjuterit **"IM10 Touch Screen"**.
- **Kjo është shkelje flagrante sepse:**
 - **IM10** nuk është lloj ekrani apo standard. **IM** do të thotë **IMESA** (është emri i markës së tyre).
 - Është një lloj si të shpallësh tender për telefona dhe të shkruash në specifikime: *"Telefoni duhet të ketë sistemin iOS të Apple"*. Asnjë kompani tjetër në botë nuk lejohet të shesë ekran IM10.
 - Përveç kësaj, kanë kopjuar emrat e patentave të IMESA-s si *"D-FLOW"* (mënyra si qarkullon ajri) dhe *"Drawer Filter"* (filtri si sirtar).

4. Mangëli / Hekuri Industrial 2 metra (Pozicioni 4)

- Këtu kanë vendosur një detaj që shpërfaq kopjimin e plotë: **"Pesha neto: 213.8 kg"**.
- **Pse është e pamundur për të tjerët të arrihet kjo specifikë?**
 - Pse i nevojitet një spitali apo lavanderie që hekuri të peshojë fiks 213.8 kg (me gramë) dhe jo 230 kg apo 240 kg? Pesha nuk ndikon fare në cilësinë e hekurosjes!
 - 213.8 kg është pesha ekzakte kur e vendos në peshore modelin **IMESA FI 200/33**.
 - Po ashtu kanë shkruar emrin e patentës së sigurisë *"Chest Safety Release"*, të

cilën prodhuesit e tjerë e quajnë ndryshe (p.sh. *Finger Guard* ose *Emergency Bar*).

Kushti që të gjitha pajisjet të jenë nga i njëjti prodhues

Përshkrimi i këtij kushti (kërkesa që të gjitha pajisjet të jenë në mënyrë obligative **nga i njëjti prodhues / brand**) përbën **stacionin e dytë të shkeljes ligjore**, madje ndër më kryesoret në prokurimin publik.

1. Pajisjet NUK lidhen fare me njëra-tjetrën?

Në një lavanderi industriale (spital, konvikt, apo hotel), procesi i punës përbëhet nga pajisje të pavarura që punojnë me parakushte plotësisht të ndryshme:

1. Makinat Larëse (Pozicioni 1 & 2):

- Lidhen me ujë të ftohtë/të ngrohtë, shkarkim uji dhe energji elektrike.
- Lajnë rrobat dhe i shtrydhin.

2. Tharësja (Pozicioni 3):

- Nuk ka fare hyrje uji apo shkarkim uji. Lidhet vetëm me energji elektrike dhe tubacion daljeje ajri (ventilim).
- Funksionon tërësisht më vete dhe nuk ka asnjë ndërveprim elektrik, elektronik apo mekanik me makinën larëse.

3. Mangëli / Hekuri Industrial (Pozicioni 4):

- Lidhet vetëm me energji elektrike për të ngrohur rulon.
- Përdoret vetëm për çarçafë e jastekë (rrobat e tjera si uniformat as nuk futen fare në mangël).

Të gjitha këto pajisje mirëmbahen nga **teknikë elektrike/mekanike të përgjithshëm** të kompanisë që fiton tenderin. Nuk ka absolutisht asnjë lidhje nëse tekniku kontrollon një motor larëseje të një brendi apo një rezistencë tharëseje të një brendi tjetër. Çdo pjesë e këmbimit (rripa, kushineta, rezistenca, kontaktorë) porositet sipas kodit të secilës pajisje veç e veç.

Shkelja e Parimit të Barazisë dhe Mos-Diskriminimit

- **Realiteti i tregut:** Në botë ka prodhues që janë të specializuar **VETËM** për makina larëse (p.sh. fabrikat që bëjnë vetëm larëse ultra-profesionale), prodhues që janë specialistë **VETËM** për manguj/hekura (si p.sh. marka e njohur globale **GMP** e cila prodhon *vetëm* manguj hekurosjeje), ose marka që prodhojnë vetëm tharëse.
- Duke kërkuar që të katërtat të jenë nga një markë e vetme, Autoriteti Kontraktues skualifikon automatikisht distributorët që sjellin larëse nga brendi 'X' dhe manguj super-cilësorë nga brendi 'Y'.

Shkelja e Parimit të Efikasitetit dhe Prokurimit me Çmimin më të Ultë/Ekonomik

Duke detyruar operatorët të ofrojnë vetëm një brand:

- Bllokohet mundësia e Operatorit Ekonomik për të kombinuar pajisjet në mënyrë që t'i ofrojë shtetit/spitalit **çmimin më të lirë dhe cilësinë më të lartë** (p.sh. larëse Electrolux + mangël GMP).
- Kjo e detyron autoritetin të blejë me çmim më të shtrenjtë nga i vetmi ofertues që i ka të katërta pajisjet nga e njëjta fabrikë (në këtë rast IMESA).
- Nëse një operator arrin të gjejë një makinë larëse nga një brand tjetër që përmbush me vështirësi parametrat e Pozicionit 1, ai përsëri **nuk mund të konkurrojë dot**, sepse te Pozicioni 3 i kërkohet paneli ekzakt "*IM10 Touch Screen*" i IMESA-s.
- Për shkak të kushtit "Same Brand", dështimi në specifikimin e njërit pozicion (p.sh. te paneli i tharëses) automatikisht të skualifikon nga e gjithë dosja e tenderit!

Pretendimi ynë se specifikat teknike të kërkuara janë përshtatur për një prodhues të caktuar, konkretisht IMESA LM 26, vërtetohet edhe përmes krahasimit ndërmjet pozicionit 1 dhe pozicionit 6 të kësaj procedure.

Këto dy pozicione kanë të njëjtin funksion, kanë të bëjnë me furnizimin e makinave larëse industriale dhe janë të parapara për instalim në të njëjtin lokacion, përkatësisht në QIRSKP – Shtime. Për këtë arsye, përputhja e specifikave teknike ndërmjet këtyre dy pozicioneve është tregues i qartë se kërkesat e përcaktuara nuk janë vetëm kërkesa të përgjithshme funksionale, por përkojnë me karakteristikat teknike të një modeli specifik, konkretisht IMESA LM 26.

Andaj, fakti që këto specifika janë reflektuar në pozicionin 6, i cili ka të njëjtin funksion dhe të njëjtin vend instalimi me pozicionin 1, e konfirmon pretendimin tonë se kërkesat teknike janë përshtatur sipas një prodhuesi të caktuar.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e lartcekura kuptohet qartë se dosja e tenderit nuk është përgatitur në harmoni me legjislacionin në fuqi, pasi që janë vendosur kërkesa diskriminuese të cilat ju pamundësojnë ofertimin kompanive të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht favorizojnë kompani të caktuara.

Ne me dt.23.07.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, por që nuk janë dhënë fakte dhe argumente të mbështetura në dispozita ligjore për një refuzim të tillë.

Në lidhje me pretendimin tonë se specifikimet teknike janë hartuar në favor të prodhuesit IMESA AK-ja është arsyetuar se pretendimi ynë nuk është mbështetur me prova të mjaftueshme dhe se specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e nevojave funksionale të autoritetit kontraktues, pa favorizuar ndonjë prodhues të caktuar.

Ky arsyetim nuk qëndron, pasi që ne kemi bashkëngjitur analizë krahasuese ndërmjet specifikimeve teknike të AK-së dhe katalogut të prodhuesit IMESA, si dhe analiza krahasuese me disa nga prodhuesit kryesor të këtyre pajisjeve siç janë prodhuesit DOMUS, PRIMUS, ELECTROLUX PROFESSIONAL dhe FAGOR. AK-ja nuk ka analizuar asnjërën nga këto prova, por vetëm ka deklaruar se pretendimet tona nuk janë të bazuara, pa dhënë ndonjë analizë teknike që rrëzon dokumentacionin e paraqitur nga ne. Prandaj në këtë rast shihet qartë se AK-ja në asnjë mënyrë nuk ka mund të dëshmojë të kundërtën e pretendimit tonë ankimor por ka dhënë vetëm arsyeime të përgjithshme të pa mbështetura në dëshmi konkrete.

Në lidhje me arsyetimin e AK-së se në dokumentacionin e tenderit nuk është përdorur emri i ndonjë marke, prodhuesi, modeli ose origjine të caktuar, ky qëndrim nuk është i bazuar dhe nuk e adreson thelbin e pretendimit tonë ankimor. Fakti që AK-ja nuk ka përmendur në mënyrë eksplicite emrin e prodhuesit IMESA në dokumentet e tenderit, nuk nënkupton automatikisht se specifikimet teknike nuk janë hartuar në favor të një prodhuesi të caktuar.

Favorizimi i një prodhuesi nuk përcaktohet vetëm nga përdorimi i drejtpërdrejtë i emrit të markës, por edhe nga mënyra e hartimit të specifikimeve teknike, ku kërkesat teknike mund të jenë aq specifike dhe të detajuara sa përputhen në mënyrë të veçantë me karakteristikat e një produkti të caktuar dhe kufizojnë konkurrencën. Pikërisht për këtë arsye, legjislacioni i prokurimit publik kërkon që specifikimet teknike të jenë të hartuara në mënyrë proporcionale, funksionale dhe të mos krijojnë avantazh të padrejtë për operatorë apo prodhues të caktuar.

Në rastin konkret, pretendimi ynë nuk është bazuar vetëm në faktin se është përdorur ose jo emri i prodhuesit IMESA, por në analizën krahasuese ndërmjet kërkesave teknike të përcaktuara nga AK-ja dhe karakteristikave teknike të produkteve të këtij prodhuesi. Kjo analizë tregon përputhje të veçantë të specifikimeve të kërkuara me produktet e IMESA-s, ndërsa prodhues të tjerë të njohur në këtë fushë, si DOMUS, PRIMUS, ELECTROLUX PROFESSIONAL dhe FAGOR, nuk i plotësojnë në të njëjtën mënyrë këto kërkesa.

Prandaj, arsyetimi i AK-së se nuk është përdorur emri i markës ose prodhuesit nuk mund të konsiderohet si përgjigje ndaj pretendimit tonë, pasi çështja kryesore nuk është përdorimi formal i një emri tregtar, por efekti praktik i specifikimeve teknike të vendosura, të cilat duhet të vlerësohen nëse lejojnë konkurrencë reale dhe të barabartë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Në lidhje me pretendimin tonë se specifikimet teknike kufizojnë konkurrencën AK-ja është arsyetuar se specifikimet teknike janë hartuar sipas nevojave të autoritetit kontraktues dhe nuk e kufizojnë konkurrencën.

Ky arsyetim është i pa bazuar dhe nuk mbështetet me asnjë analizë konkrete, sepse siç edhe e cekëm më lartë ne kemi dëshmuar se prodhues të njohur ndërkombëtarë nuk arrijnë t'i plotësojnë në tërësi kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit. AK-ja nuk ka argumentuar pse secila kërkesë është e domosdoshme dhe proporcionale, por vetëm ka përsëritur se ato burojnë nga nevojat e tij.

Në lidhje me pretendimin tonë për paqartësinë lidhur me konfigurimin e makinave larëse AK-ja është arsyetuar se operatorët ekonomikë mund të ofertojnë cilëndo nga konfigurimet e lejuara, përderisa plotësojnë nevojat funksionale të autoritetit kontraktues.

Ky arsyetim i AK-së nuk qëndron sepse ne nuk kemi kundërshtuar lejimin e alternativave, por mungesën e qartësisë në dokumentacion. AK-ja nuk e ka sqaruar nëse të gjitha konfigurimet do të konsiderohen plotësisht të barasvlershme gjatë vlerësimit të ofertave, gjë që krijon paqartësi dhe cenon parimin e transparencës.

Në lidhje me konstatimin e AK-së se barra e provës nuk është përmbushur nga operatori ekonomik, sqarojmë se ky konstatim është i pabazuar. Ne edhe një herë po e sqarojmë se në kërkesë për rishqyrtim e edhe tani në ankesë kemi bashkëngjitur analiza krahasuese, katalogë teknikë dhe dokumentacion nga prodhues të ndryshëm ndërkombëtarë, të cilët përbëjnë prova objektive. AK-ja nuk ka kundërshtuar asnjëherë prej këtyre provave me ndonjë analizë profesionale, por vetëm i ka mohuar në mënyrë të përgjithshme.

Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i paqëndrueshëm dhe jo profesional, për më tepër me këto veprime të AK-së po vërtetohet fakti se në këtë aktivitet të prokurimit po favorizohen OE të caktuar.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*.

Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur.

Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”*.

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin 17.7 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që *“Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”*.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë*.

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesat të cilat i kontestuar më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se *“Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”*.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **“MSI” SH.P.K.**

NDRYSHOHET dosja e tenderit dhe specifikimet teknike dhe pastaj të vepohet konform nenit 53.7 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurat ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.